

KONTROLL TREGUT TË HIDROKARBUR- REVE

MIE përmes Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial në kuadër të aksionit kundër informalitetit ka intensifikuar kontrollet në tregun e hidrokarbureve. Aksioni do shtrihet në të gjithë subjektet, që tregtojnë, nxjerrin apo përpunojnë hidrokarbure, ndërsa masat do të jenë tepër të ashpra për ata të cilët abuzojnë. Brenda muajit shtator përfundon edhe ristrukturimi i ISHTI duke rritur numrin e personelit për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave për rritjen e cilësisë së punës së këtij institucioni.

DHURIM GJAKU PËR FËMIJËT TALASEMIKË

Stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucioneve të varësisë ju bashkuan nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar për dhurimin vullnetar të gjakut për t'ju ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë. Ky shembull i solidariteti dhe humanizmit do të vijojë edhe në muajt e ardhshëm me qëllim për t'ju gjendur pranë njerëzve në nevojë.

LEHTËSIM SHËRBIMEVE PËR QYTETARËT

Që prej datës 15 Gusht, personalizimi, lëshimi i kartonit të ri të leje drejtimit realizohet në vetëm 30 minuta duke ofruar kështu një tjetër lehtësim për qytetarët. Risia nisi me Tiranën, drejtoria e cila përballon 45% të numrit total të leje drejttimeve në Shqipëri. Falë investimeve dhe pajisjeve moderne tashmë shpejtohet procesi për ofrimin e 7 shërbimeve dhe e gjitha ofrohet pa tarifë shtesë.

REHABILITIM AKSIT MALIQ- LOZHANË

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka vijuar punën për riveshjen pjesore dhe riparimin e shtresave asfaltike në aksin rrugor Maliq-Lozhanë. Rehabilitimi i këtij segmenti rrugor u jep mundësi banorëve të zonës përgjatë këtij aksi si dhe përdoruesve të tij të mund të udhëtojnë në kushte më komode dhe me më tepër siguri.

DPSHTRR, 7 SPORTELE TË REJA SHËBRIMI

7 sportele të reja ndihmëse janë hapur pranë zyrave të DPSHTRR për t'ju ofruar një shërbim më të shpejtë qytetarëve të cilët paraqiten për tërheqjen e leje drejtimit, leje drejtimi e leje qarkullimi ndërkombëtare, targa suvenir, tahograf, komoditeti bus e taksi, licensa, si dhe shërbime të tjera. Hapja e këtyre sporteleve ndihmëse bën të mundur uljen e radhëve gjatë periudhës së fluksit në mënyrë që qytetarët të kursejnë sa më shumë kohë.

INVESTIMI NË HEC-FIERZË

Në Hec-Fierzë po vijon puna për përfundimin e pilotave dhe barrierës së betonit i cili do të bëjë të mundur mbrojtjen e pjesës së majtë të bjetit të poshtëm nga rrëshqitjet. Punimet për përfundimin e këtij investimi të rëndësishëm janë duke ecur me ritme të kënaqshme dhe pritjet të përfundojë brenda afatit të parashikuar.